

FAQ Coronaschutzverordnung - gültig bis vorerst 30. September

Urdhëresa për Mbrojtjen nga Koronavirusi – e vlefshme përkohësisht deri në 30 Shtator

Sa do të zgjasë urdhëresa për mbrojtjen nga koronavirusi?

Rregulloret për mbrojtjen nga koronavirusi janë zgjatur: Ato vlejné të paktën deri në 30 Shtator 2020.

Kur janë të nevojshme adaptimet rajonale ndaj ecurisë së infeksionit?

Qeveria e Landit vazhdon të synojë frenimin e numrit të infeksioneve nëpërmjet masave të përshtatura rajonale. Do të implementohet një masë për frenimin e koronavirusit duke filluar nga 35 infeksione të reja në 100.000 banorë brenda 7 ditëve (Incidenca e 7 ditëve). Duke filluar nga ky limit, komunat e afektuara, Qendra e Shëndetësisë e Landit dhe qeveria përgjegjëse e qarkut duhet të bien dakord menjëherë për marrjen e masave të tjera mbrojtëse konkrete për vënien nën kontroll të infeksionit. Duke filluar nga një incidencë 7 ditore me vlerën 50, janë të detyrueshme masa të tjera mbrojtëse. Në këto raste, duhet të përfshihet në konsultime Ministria e Punës, e Shëndetësisë dhe e Çështjeve Sociale.

Cilat rregulla vlejné në lidhje me akomodimet?

Nëse vizitorët vijnë nga një zonë, për të cilën vlen një urdhëresë rajonale e veçantë për shkak të një rritje të shkallës së infektimit, këto persona duhet të frekuentojnë hotele, pensione dhe bujtinat e të rinjve vetëm nën kushte specifike. Për këtë rast duhet të jetë prezent një test negativ për koronavirusin. Ky test duhet të kryhet jo më shumë se 48 orë (Koha kur është përcaktuar rezultati i testimit është vendimtare) para udhëtimit.

Shënim: Nuk afektohet akomodimi për arsye detyruese të nevojshme profesionale ose arsye të tjera bindëse (Vizitë nga familjarë, partnerë jete etj).

A është zgjatur masa për detyrimin e mbajtjes së maskës?

Po, momentalisht deri më 30 shtator.

Në cilat raste duhet mbajtur maska me detyrim?

Kryesisht vlen ky rregull: Duhet të mbahet një maskë e cila mbulon gojën dhe hundën në të gjitha mjediset e tregëtisë, kulturës dhe kohës së lirë ku ka qarkullim publiku dhe klientësh si dhe trafik pasagjerësh, gjithashtu dhe në klinika mjekësore dhe mjedise të ngjashme të kujdesit shëndetësor.

Shënim: Personi i cili shpërfill detyrimin për mbajtjen e maskës, nuk do të mund të shfrytëzojë shërbimet përkatëse ose të hyjë në ambientet e caktuara.

A ka përjashtime nga detyrimi për mbajtjen e maskës?

Po. Detyrimi për mbajtjen e maskës nuk vlen për fëmijë, të cilët nuk shkojnë ende në shkollë. Gjithashtu nga ky detyrim përjashtohet kush nuk mban dot një maskë për mbulimin e hundës dhe të gojës për arsye shëndetësore. Arsyet mjekësore duhet të vërtetohen nga një çertifikatë mjekësore e cila duhet të paraqitet sipas kërkesës. Për më tepër, maska mund të hiqet përkohësisht për arsye specifike, për shembull gjatë komunikimit me persona të cilët janë të shurdhër ose kanë probleme me dëgjimin.

A do të vazhdojnë të zbatohen kontrollet dhe ndëshkimet për shkeljet e detyrimit për mbajtjen e maskës?

Po. Veçanërisht në transportin publik shkeljet e detyrimit të maskave ndëshkohen direkt si kundravajtje administrative me një gjobë prej 150 eurosh. Në rastet e tjera të detyrimit të maskës , gjoba është 50 euro.

Si duhen kuptuar rregulloret për ndalimin e kontaktit fizik?

Njëlloj si më përpara, mund të takohen në publik grupet me jo më shumë se 10 njerëz . Ky numër maksimal personash nuk vlen për të afërmit të cilët rrjedhin në mënyrë direkte nga njëri tjetri, për shembull babai dhe djali, gjyshja dhe nipi ose për personat të cilët janë pjesë e njësisë ekonomike familjare të ndryshme. Rregulla e përgjithshme e distancimit prej 1.5 metrash vazhdon të vlejë, gjithashtu dhe detyrimi për mbajtjen e një maske në mjedise të caktuara e cila mbulon hundën dhe gojën.

A vlejné rregullat e distancimit për dhomat e votimit gjatë zgjedhjeve lokale?

Po. Në dhomat e votimit dhe në radhët e pritjes vlejné detyrimi për mbajtjen e një maske e cila mbulon hundën dhe gojën. Vetëm punonjësit e stafit të zgjedhjeve mund të heqin dorë nga mbajtja e maskës e cila mbulon hundën dhe gojën tek qendra e votimit nëse mbajnë distancën minimale nga individët e tjerë.

Një pyetje për personat me aftësi të kufizuara: A mund të shoqërohen ata nga persona mbështetës ose nga kujdestarët në takime me grupe të tjera personash?

Po. Përveç numrit të caktuar të personave ose të njësisë familjare , një person mbështetës mund të jetë prezent nëse keni nevojë për suport.

Si duhet ta kuptojmë gjurmueshmërinë e thjeshtë dhe të veçantë?

Nëse infektoheni me koronavirusin , duhet të bëhet e mundshme vendosja në dispozicion e të dhënave të kontaktit të personave me të cilët jeni takuar tek autoritetet shëndetësore. Në mënyrë që këto kontakte të mund të gjurmohen, mikpritësit, qeradhënësit, menaxherët e ndërtesave, pronarët e kështu me radhë duhet të dokumentojnë me shkrim me aprovimin e tyre të gjithë

vizitorët prezentë me emrin e tyre, adresën, numrin e telefonit dhe nëse është e përshtatshme periudhën e qëndrimit dhe t'i ruajnë të dhënat në mënyrë të sigurt për katër javë.

Të dhënat duhet të mbrohen nga aksesimi i personave të paautorizuar dhe duhet të shkatërrohen totalisht pas 4 javëve. Kjo quhet „Gjurmueshmëria e thjeshtë“.

„Gjurmueshmëria e veçantë“ ndodh kur përveç të dhënave më lart, krijohet një plan i cili tregon ku janë ulur njerëzit. Një plan i tillë nuk është i detyrueshëm. Për evenimente të caktuara mund të hiqet dorë nga parimi i ruajtjes së distancës minimale midis vendeve nëse ekziston një plan i cili tregon ku janë ulur njerëzit. Nëse zgjidhet ky opsion, plani i cili tregon ku janë ulur njerëzit duhet të ruhet për 4 javë.

Cilat rregulla vlejnë për evenimentet dhe mbledhjet?

Evenimentet dhe mbledhjet me më shumë se 300 pjesëmarrës mund zënë vend nëse sigurohen masa të përshtatshme për higjienën, kontrollin e hyrjes dhe garantimit të distancës minimale prej 1.5 metrash (gjithashtu në radhët e pritjes).

Me përjashtim të ambienteve të hapura, duhet të sigurohet gjithashtu gjurmueshmëria e thjeshtë. Nëse pjesëmarrësit janë të ulur në vende fikse gjatë eventit, nuk është i nevojshëm të zbatohet parimi i ruajtjes së distancës minimale, duke patur parasysh se është siguruar gjurmueshmëria e veçantë. Gjithashtu në ambiente të mbyllura duhet të vendosen maskat nëse individët nuk janë të ulur tek vendet e tyre. Evenimente me më shumë se 300 pjesëmarrës kërkojnë një plan të veçantë higjienë dhe mbrojtje nga infeksioni. Evenimente të mëdha festive qëndrojnë të ndaluar deri në 31 dhjetor 2020; këto përfshijnë për shembull festimet popullore të mëdha, panairët, festat e rrugës, të fshatit dhe të qytetit, festat e qitjes ose të verës.

Cilat rregulla vlejnë për evenimente shoqërore si për shembull dasmat?

Vazhdon të jetë i vlefshëm limiti i 150 personave. Për stafin e pranishëm (Kamarierë, teknikë, etj) vlen detyrimi për mbajtjen e maskës për arsye mbrojtëse si në ambiente të mbyllura ashtu dhe në ambiente të jashtme, por këta individë nuk përfshihen tek numri i 150 personave.

Cilat janë rregullat e reja për evenimentet me më shumë se 500 persona?

Për evenimente me më shumë se 500 persona, plani i higjienës i cili ka qenë i zhvilluar deri tani duhet të tregojë shprehimisht se mbërritja dhe ikja e një numri kaq të madh njerëzish tek eventimi mund të zhvillohet në përputhje me çështjen e mbrojtjes nga infeksioni psh që sistemi i transportit publik nuk do të mbingarkohet nga pasagjerët shtesë.

Cilat janë rregullat e reja për evenimentet me më shumë se 1.000 persona?

Më shumë se 1.000 persona mund të mblidhen së bashku vetëm nëse vendi ku do të zhvillohet evenimenti është shfrytëzuar maksimumi në një të tretën e kapacitetit të tij normal. Kjo do të thotë se 1.000 persona mund të takohen vetëm tek vendet të cilat janë të dizenuara për të paktën 3.000 persona jashtë limiteve të koronavirusit. Rregulli përshtatet siç duhet për numër më të lartë pjesëmarrësish.

Gjithashtu është paraqitur së fundmi rregullorja kombëtare e cila tregon se duke filluar nga shifra e 1.000 personave, nuk duhet të japin aprovimin e tyre për evenimentin vetëm autoritetet lokale por edhe Ministria e Shëndetësisë. Kjo ndodh sepse evenimente të tilla të mëdha nuk kanë zakonisht rëndësi vetëm në nivel lokal. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për koordinimin me Ministrinë e Shëndetësisë.

A ka rregulla të veçanta për evenimentet kulturore?

Vlejnë kërkesa të ngjashme si për evenimente të tjera: masa parandaluese të përshtatshme higjiene, kontroll i hyrjes, distanca thelbësore minimale, ajrosje e vazhdueshme e ambientit, sigurim i gjurmueshmërisë së thjeshtë dhe nëse është e nevojshme detyrimi i mbajtjes së maskës. Nëse ka më shumë se 300 spektatorë, evenimenti lejohet vetëm nën kushtin e një plani higjiene të veçantë dhe mbrojtje nga infeksioni.

Cilat rregullore vlejnë për sportet në grup dhe të kohës së lirë?

Veprimtaritë sportive dhe trajnuese në mjedise sportive private ose publike si dhe në hapësira publike janë të mundshme nën disa kushte të caktuara. Këto përfshijnë masat e përshtatshme të higjiensës, të kontrollit të hyrjes dhe të garantimit të një distance minimale prej 1.5 metrash , edhe në dhoma dushi, larje dhe zhveshje. Në rastin e sporteve në salla të mbyllura , duhet të sigurohet gjithashtu ajrosja e mirë.

Cilat rregulla vlejnë për sportet me kontakt fizik?

Grupet me deri në 30 persona ose 2 skuadra, duke përfshirë të gjithë lojtarët dhe lojtaret e lejuar nga Statuti i Shoqatës ose rregullat e lojës, mund të praktikojnë sportet me kontakt fizik. Duhet të sigurohet gjurmueshmëria e thjeshtë.

Festivalet sportive dhe evenimente të ngjashme qëndrojnë të ndaluara deri të paktën në 31 dhjetor 2020.

Cilat rregulla vlejnë për edukimin fizik?

Tek edukimi fizik mund të zhvillohen gjithashtu sportet me kontakt fizik . Po ashtu është i mundur mësimi i notit.

Nën cilat kushte janë të mundura konkurset sportive?

Ketu vlejnë kushtet e zbatimit të masave parandaluese për higjiensën, mbrojtjen nga infeksionet, të kontrollit të hyrjes dhe të garantimit të një distance minimale prej 1.5 metrash .

Për sportet profesionale vlejnë rregullore të veçanta të cilat lejojnë nën kushtet e caktuara ligat profesionale si dhe konkurset e kalorësve profesionistë dhe garat e kuajve.

Sa spektatorë lejohen tek ndeshjet në ligat rajonale ose në konkurse?

Duke filluar nga data 16 shtator, më shumë se 300 spektatorë do të lejohen sërish të marrin pjesë tek ndeshjet në ligat rajonale ose në konkurse, duke patur parasysh se është paraqitur një plan higjienë dhe mbrojtje nga infeksioni. Nëse ka më shumë se 1.000 spektatorë, do të ketë një limit sipëror prej 1/3 e kapacitetit të mjedisit sportiv; e njëjta gjë vlen dhe për eventet e tjera.

Cila është rregullorja në lidhje me spektatorët për evente sportive kombëtare?

Landet ranë dakord për një rregullore të përbashkët më 15 shtator në lidhje me eventet sportive kombëtare, përfshirë dhe ndeshjet e Bundesligës. Numri i lejuar i spektatorëve do të përcaktohet individualisht për çdo vendndodhje eventi. Kapaciteti maksimalisht i lejuar gjatë një periudhe prove 6 javore është sa 20 përqind e kapacitetit të stadiumit përkatës ose të sallës nëse ka më shumë se 1.000 spektatorë. Kërkesa e distancës prej 1.5 metrash duhet të plotësohet duke reduktuar kapacitetin maksimal të audiencës, duke ekuilibruar rrjedhën e vizitorëve tek hyrja dhe tek dalja dhe duke ndaluar shërbimin dhe konsumin e alkoolit. Është e detyruar mbajtja e maskës e cila mbulon hundën dhe gojën, deri sa të qëndroni në këmbë ose të rrini ulur. Të gjitha vendet e spektatorëve duhet të caktohen në mënyrë fikse. Biletat e mysafirëve mund të mos shpërndahen. Nuk do të lejohen spektatorë në evente nëse incidenca 7 ditore për 100.000 pjesëmarrës tek vendndodhja e eventit është 35 ose më e madhe se 35 dhe nëse incidenca e infeksionit nuk mund të kufizohet dukshëm.

A mund të hapen saunat si dhe banjat termale dhe pishinat e argëtimit?

Po, mund të hapen sërish banjat termale, parqet ujore dhe pishinat e argëtimit. Saunat dhe mjedise të ngjashme mund të rifillojnë gjithashtu veprimtarinë. Këto mjedise mirëqenie mund të fillojnë të përdoren sërish në veprimtari akomoduese. Duhet respektuar rregulloret e higjienës dhe të mbrojtjes nga infeksioni.

Cilat lehtësime ekzistojnë në fushën e tregëtisë?

Duke filluar nga data 15 qershor, ka patur gjithashtu lehtësime për kufizimin e hyrjes në lidhje me sipërfaqen tek fusha e tregëtisë. Këto janë zgjeruar nga një person për dhjetë metër katror në një person për 7 metër katror të hapësirës së shitjes në dyqan.

A vlen kjo gjithashtu për muzetë, ekspozitat si dhe për kopshtet zoologjike?

Po, edhe aty limiti i vizitorëve është zgjeruar nga 1 person për 10 metër katror në një person për 7 metër katror.

A mund të qëndrojnë të hapura baret?

Po, baret mund të qëndrojnë të hapura nën kushte të caktuara.

Çfarë do të ndodhë në lidhje me klubet, diskotekat dhe shtëpitë publike?

Klubet, diskotekat dhe ambiente të ngjashme qëndrojnë të mbyllura. Veprimtaria e ambienteve dhe mjeteve të transportit të prostitucionit lejohet vetëm në përputhje me standartet e higjienës dhe të mbrojtjes nga infeksioni të përcaktuara tek aneksi i Urdhërësës për Mbrojtjen nga Koronavirusi. Evenimentet në lidhje me prostitucionin sipas seksionit 2 paragrafi 6 i Aktit të Mbrojtjes të Prostitutave nuk lejohen.

Cilat rregulla vlejné për gastronominë?

Mund të ulen akoma maksimumi dhjetë veta në një tavolinë - ose persona të një njësie ekonomike familjare ose të afërm të cilët rrjedhin në mënyrë direkte nga njëri tjetri për shembull babai dhe djali, gjyshja dhe nipi. Duhet marrë masa parandaluese të përshtatshme për higjienën, mbrojtjen nga infeksionet, kontrollin e hyrjes dhe garantimin e një distance minimale prej 1.5 metrash si dhe gjurmueshmëria; rregullore të detajuara gjenden tek standartet përkatëse të higjienës dhe të mbrojtjes nga infeksioni.

Tek veprimtaritë gastronomike mund të organizohen nën kushte të caktuara edhe festa (për shembull festa dasmash, ditëlindje të rëndësishme) me maksimumi deri në 150 njerëz.

Cilat rregulla vlejné për baret të cilat ofrojnë nargjile?

Pipa e nargjiles nuk duhet të përdoret nga shumë njerëz në të njëjtën kohë dhe duhet të përdoret vetëm me pipëza një përdorimshe dhe zorra të cilat hidhen në plehra pas përdorimit dhe gjithashtu vetëm nëse mjediset janë ajrosur totalisht dhe vazhdimisht.

A lejohet barbekju?

Po, barbekju në hapësira publike lejohet nën kushte të caktuara. Duhet respektuar kufizimet e kontaktit (vetëm grupe deri në 10 persona, familjarë të ngushtë, individë nga dy njësi ekonomike familjare të ndryshme).